

VENDIM
Nr. 116, datë 15.2.2012

PËR RIORGANIZIMIN E STATISTIKAVE BUJQËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të neneve 11 e 17 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Instituti i Statistikave (në vijim INSTAT) do të jetë institucioni i vetëm përgjegjës në vend për grumbullimin, prodhimin, analizën dhe përhapjen e statistikave të bujqësisë dhe shkëmbimeve tregtare për produktet bujqësore dhe blegtorale.

2. Transferimi i kompetencave për statistikat bujqësore, nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit tek INSTAT-i, do të bëhet në dy faza, si më poshtë vijon:

a) Faza e parë do të jetë ngritja e strukturës së statistikave të bujqësisë pranë qendrës së INSTAT-it, e përbërë nga 27 (njëzet e shtatë) punonjës. Kjo fazë mbyllet tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

b) Në përfundim të fazës së parë, struktura aktuale e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (sektorët e statistikave) pakësohet me 27 (njëzet e shtatë) punonjës dhe fondi i pagave për këta punonjës i transferohet INSTAT-it.

c) Faza e dytë do të jetë ngritja e strukturave të statistikave bujqësore në varësi të INSTAT-it, në çdo qark të vendit. Kjo fazë mbyllet brenda datës 31 dhjetor 2012.

ç) Në përfundim të fazës së dytë, struktura aktuale e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (sektorët e statistikave) pakësohet me 20 (njëzet) punonjës. Fondi i pagave për këta punonjës i transferohet qendrës së INSTAT-it.

3. Gjatë vitit 2012, përgjegjësitë e institucioneve për statistikat bujqësore do të jenë, si më poshtë vijon:

a) Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit do të organizojë vërtetimet 6 - mujore dhe vjetore për treguesit e prodhimit bujqësor dhe blegtoral.

b) Të dhënat e vërtetimeve do t'i dërgohen INSTAT-it, i cili do të bëjë përpunimin, analizën dhe publikimin e treguesve për prodhimin bujqësor dhe blegtoral, për vitin 2012.

c) INSTAT-i me stafin e tij në qendër merr pjesë dhe vërteton procesin e intervistave në terren nga specialistët e MBUMK-së.

4. Brenda datës 31 dhjetor 2012, të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë për statistikat bujqësore në vend i transferohen INSTAT-it.

5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe INSTAT-i për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha